



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.33, datë 26.03.2026

“PËR STREHIMIN E FAMILJEVE NË NEVOJË, KASTRIOT HIDËRSHAJ DHE RIZA LIÇOLLARI NË OBJEKTET E KTHYERA NË FOND BANESE ME VENDIM TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.62, DATË 27.11.2025” PËR KTHIMIN NË FOND BANESE TË DY OBJEKTEVE: ISH-KOPSHTI I FËMIJËVE NË LAGJEN “HASAN SEITAJ” DHE ISH ZYRAT E VJETRA TË NDËRMARRJES PYJORE, PËR QËLLIME STREHIMI”.

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 26.03.2026, mori në shqyrtim projektaktin e mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligji nr.22/2018 “Për strehimin Social” i ndryshuar, VKM-së nr 898, datë 18.11.2020 Për rregullat, kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave dhe të objekteve të kthyer në fond banese të paprivatizuara”, ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, VKM-në 458, datë 03.07.2019 “Për procedurën e kthimit në fond banese, me qëllim strehimi, të objekteve prone shtetërore, që përshtaten nga njësitë e vetëqeverisjes vendore me grante konkurruese nga buxheti i shtetit “, VKM-në 902, datë 21.12.2011 ‘Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtëshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Çorovodë, të Qarkut Berat”, nr.62, datë 27.11.2025 ‘Për kthimin në fond banese të dy objekteve: ish-kopshti i fëmijëve në lagjen “Hasan Seitaj” dhe ish-zyrat e vjetra të Ndërmarrjes Pyjore, për qëllime strehimi,

VENDOSI:

1-Strehimin e familjes në nevojë të z.Kastriot Hidërshaj, në objektin ish Kopshtim i fëmijëve Lagja ‘Hasan Seitaj’ nr.pasurie 6/68.

2-Strehimin e familjes në nevojë të z.Riza Liçollari në objektin ish Zyrat e vjetra Hambull, të Ndërmarrjes së Shërbimit Pyjor, Skrapar.

Vendimi u miratua me 12 Vota pro, vota kundër - s’ka , abstenim – s’ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Elsa PETRITAJ

